

## **STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **“KAÇORRI 3” sh.p.k**

Sot, me date **07.04.2022**, me deshiren dhe vullnetin e tij te lire dhe te pavarsuar **Z. Besnik KAÇORRI**, i biri i Pjetrit, lindur me 22.03.1975 ne Rreshen dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plete per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi shqiptare, i identifikuar me ane te leternjofteimit me nr.032402606, ne cilesine e ortakut themelues krijon:

Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **“KAÇORRI 3” sh.p.k** Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare si dhe zhvillimi i metejshem i saj.

#### **KREU I**

#### **NENI 1**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**1.1** Ortaku i vetem i kesaj shoqerie eshte:

**Z. Besnik KAÇORRI** ne masen **100 %**

#### **NENI 2**

#### **EMERTIMI I SHOQERISE**

**2.1.** Shoqeria mban emrin **“KAÇORRI 3” sh.p.k** dhe eshte person juridik shqiptar.

**2.2.** Kjo shoperi e fiton statusin e saj juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

**2.3.** Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontrata respektive.


#### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQERISE**

**3.1.** Shoqeria e ka qendren ne malin e Kashnjetit Kolsh, LEZHE, godina NR.1 kati perdhe, Zona Kadastrale 2203, dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

**3.2.** Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

#### **NENI 4**



## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**4.1.** Shoqeria eshte themeluar per te vepruar ne fushen e :

- Ndertimit te objekteve te ndryshme publike ose private, bujzesore ose industriale.
- Prodhim, perpunim dhe tregtim inertesh, betoni dhe asfalti.
- Tregtise me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit, mallrave industriale, turistike etj.
- Import-eksport te mallrave industriale, te ndertimit dhe te mallrave te tjera te ndryshme etj.

**4.2.** Gjithashtu shoqeria do te mund te kryeje çdo aktivitet tjeter ekonomik, tregtar, finanziar, qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise.

**4.3.** Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe finanziar, te miratuar nga Asambleja e Ortakeve.

### **NENI 5**

#### **PERGJEGJESIA E ORTAKEVE**

**5.1.** Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakeve.

**5.2.** Ortaku qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte perqejges per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk perqigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

### **NENI 6**

#### **KOHEZGJATJA**

**6.1.** Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.R.

### **NENI 7**

#### **SIMBOLET E SHOQERISE**

**7.1.** Shoqeria do te kete vulen e saj ku do te shkruhet emertimi i shoqerise.



## KREU II

### NENI 8

#### KAPITALI I SHOQERISE

**8.1.** Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga para me nje vlore te barabarte me 10.000 leke, me 1 kuota me vlore nominale 10.000 leke zoteruar, shlyer teresisht nga ortaket dhe ndare ne kete menyre:

- Z. Besnik KAÇORRI 100 % te kuotave ( e barabarte me 10.000 leke).

### NENI 9

#### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

**9.1.** Kapitali themeltar ose pjese te veçanta te tij, jane te transferueshme mes ortakeve dhe tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij mes ortakeve dhe ne favor te te treteve, kryhet gjithnjë pas miratimit unanim te gjithe ortakeve dhe me akt notorial te posacem.

**9.2.** Nese nje nga ortaket deshiron te shese kuotat e tij ai duhet te respekoje te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te kesaj shoqerie.

**9.3.** Te gjitha veprimet e shoqerise qe kane te bejne me zmadhimin dhe zvogelinin e kapitalit themeltar, qe te konsiderohen te vlefshme duhet te miratohen nga Asambleja e Pergjithshme me nje shumice votash prej  $\frac{3}{4}$  te ortakeve te saj. Ne rast mosarritjeje te kompromisit zbatohen rregullat e vendosura ne Ligjin "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" ne lidhje me shumicen vendimarruese.

**9.4.** Ne rast se Asambleja e Pergjithshme vendos te rrise kapitalin themeltar te shoqerise dhe njeri nga ortaket nuk eshte ne gjendje te shlyeje pjesen e tij takuese te kuotave qe rezultojne pas rritjes, ka detyrimin per shlyerjen e tyre brenda nje afati kohor prej 6 muajsh qe nga data e zmadhimit te kapitalit.

**9.5.** Nese edhe pas kalimit te ketij afati ortaku, eshte ne pamundesi per te shlyer vleren e kuotave qe rezultojne nga zmadhimi i kapitalit themeltar, ortakeve te tjere i lind e drejta te kerkojne perjashtimin e ortakut qe nuk permbush detyrimet e parashikuara ne kete statut si dhe te gezojne te drejten e kalimit te ketyre kuotave ne favor te tyre ne perputhje me nenin 103/2 te Ligjet nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**9.6.** Ne cdo rast vleresimi i kapitalit ne natyre qe zoteron apo do te krijoje shoqeria ne te ardhmen do te behet nga ortaket me nje marreveshje te vecante ose nga nje ekspert kontabel i emeruar nga ortaket.

### NENI 10

## **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**10.1.**Kuotat e kapitalit të shoqerise dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

**10.2.**Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

**10.3.**Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

**10.4.**Kalimi i kuotave kushtezohet nga e drejta e parablerjes se tyre nga ortaket e tjere te shoqerise.

## **NENI 11**

### **LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE**

Ne çdo rast largimi dhe perjashtimi i ortakeve per shkaqe te arsyeshme ose jo, behet ne perputhje me nenet 101 dhe 102 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Shkak per perjashtimin e ortakut mund te jete mossħlyerja e kontributit te tij sipas parashikimeve ne statut.

## **KREU III**

## **NENI 12**

### **ORGANI VENDIMMARRES**

**12.1.**Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**12.2.** Asambleja e Pergjithshme, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- c) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

**12.3.**Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme duhet te regjistrohen në librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**12.4.**Asambleja e Pergjithshme, ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote qe zoterojne me shume se 30% te kuotave.  
Nese asambleja duhet te vendose per ceshtje qe kerkojne shumice te cilesuar, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo me mjete elektronike, ne perputhje me piken 3, te nenit 88, te ketij ligji.  
Kur Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumi te permendur me siper, ajo duhet te mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

**12.5.**Asambleja e Pergjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave te ortakeve pjesemarres per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin ose prishjen e shoqerise.  
Per te gjitha ceshtjet e tjera te percaktuara ne neni 81, te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", asambleja vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres.

**12.6.**Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme thirret sipas rregullave te parashikuara ne nenin 82 e vijues te ligjit te mesiperm.


## NENI 13

### ADMINISTRATORI

**13.1.** Administrator i shoqerise emerohet **Z. Besnik KAÇORRI**.

**13.2.** Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjeçar me te drejte riparteritje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**13.3.**Administratori emerohet dhe shkarkohet, ne çdo kohe, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te shoqerise.



Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

## NENI 14

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

**14.1.** Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Pergjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përparrë Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

**14.2.** Administratori eshte i detyruar të thërrase mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme edhe ne rastet kur:

- *sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.*

**14.3.** Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjithe personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetete shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

**14.4.** Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimi shqipërtore te shoqerise.

**14.5.** Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

## NENI 15

### VITI FINANCIAR

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "B. Jashari".<sup>6</sup>

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

## NENI 16

### BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

**16.1.**Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

**16.2.**Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

## NENI 17

### MBARIMI I SHOQERISE

**17.1.**Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të Asamblese se Pergjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

**17.2.**Ne kete rast Asambleja merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej saj emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

**17.3.**Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

**17.4.**Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Pergjithshme. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

## NENI 18

### TRANSFORMIMI I SHOQERISE

B. Johny 7

**18.1.** Transformimi i shoqerise behet me vendim te Ortakut te Vetem ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur Asamblese nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

**18.2.** Çdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

#### **NENI 19**

#### **BAZA LIGJORE**

**19.1.** Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**19.2.** Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### **NENI 20**

#### **MOSMARREVESHJET**

**20.1.** Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

**20.2.** Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

#### **NENI 21**

#### **DISPOZITA PERFUNDIMTARE**

Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, me vlere te njejtë juridike.

#### **ORTAKU I VETEM :**

Besnik KAÇORRI

Besnik KACORRI  
